

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

24.01.2024
Ora 15:34

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 22, datë 23.02.2022, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e Kodit të Etikës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Ylli Merkaç, Madalena Koja**

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Siç jeni në dijeni Komisioni Rregullator është vënë në lëvizje nga një nga anëtarët e tij, zoti Dritan Çaka dhe është vetëmbledhur sipas parashikimeve në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator. Në


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisioni Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues i organizatës së shoqërisë civile KRIIK. Po, faleminderit! Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme kemi një projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 22, datë 23.02.2022 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e Kodit të Etikës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.”. Meqenëse projektvendimi është propozuar nga një anëtar i Komisionit Rregullator do t’i jap fjalën zotit Çaka, propozuesit për të prezantuar ndryshimet dhe relacionin e projektaktit. Faleminderit!

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja Kyetare! Komisioni Rregullator ka miratuar me vendimin nr. 22 datë 23.02.2022, Kodin e Etikës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pavarësisht se ky është një ndër aktet, i cili nuk përfshin pjesën e veprimtarisë të Komisionit të cilat kanë të bëjnë me proceset zgjedhore, është ndër aktet më të rëndësishme që Komisioni Rregullator ka ndërmarrë. Ky akt miraton, normon rregulla, të cilat vetë struktura e organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, por edhe nëpunësit apo edhe zyrtarët e tjerë të Komisionit duhet të zbatojnë gjatë veprimtarisë dhe aktivitetit të tyre administrativ, por dhe vendimmarrës në rastin e organeve drejtuese. Gjatë punës së Komisionit Rregullator dhe veprimtarisë sonë, por edhe nga komunikimet që ne kemi pasur me struktura të tjera të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke përfshirë edhe Komisionerin, Nënkomisionerin, KAS-in, por edhe vetë administratën është parë që ky Kod Etike ka nevojë për disa rregullime, korigjime të cilat ta bëjnë më të aplikueshëm atë dhe njëkohësisht punën e të gjithë strukturave. Duke qenë se Kodi Zgjedhor na jep ne si anëtarë të Komisionit Rregullator në mënyrë individuale apo kolegjiale, të drejtën për të propozuar ndryshime të akteve që janë në fushën e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

kompetencës sonë, vlerësova që do të ishte e rëndësishme që në këtë fillim viti ta nisnim punën me një akt kaq të rëndësishëm që rregullon, po themi veprimtarinë e sjelljes të ne, të gjithëve. Për këtë arsye, kam bërë disa propozime që janë të karakterit të korigjimeve të disa gabimeve, lapsuseve që mund të jenë përfshirë brenda aktit, por edhe disa ndryshime, më saktë shtesa të disa neneve, të cilat unë vlerësoj se mungojnë dhe duhet të përshihen edhe në aktin fillestar. Kam propozuar që të bëhen disa ndryshime siç është psh në pikën 7 të Kodit të Etikës, ku janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe paraqitja në punë e zyrtarit, por pa u detajuar se cilat janë këto rregulla, apo ku është i normuar ky format. Për këtë arsye kam propozuar që të shtohet një pikë ku në këtë përmbajtje që rregullat e hollsishtme për veshjen dhe paraqitjen në punë të përcaktohen në rregulloren e brendshme. Kam propozuar disa ndryshime në lidhje me komunikimin me median të nëpunësve dhe punonjësve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe detyrimin që ka ky zyrtar ose punonjës për ruajtjen e konfidencialitetit në lidhje me të gjithë informacionit që merr gjatë punës së tij. Raportet ose kontaktet që një punonjës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, apo një zyrtar i tij mund të ketë me institucione të tjera si dhe faktin, në aktin bazë është lënë pa u normuar që shkeljet e dispozitave të këtij Kodi, duhet të ndëshkohen në rrugë administrative sipas legjislacionit në fuqi. Kështu edhe një herë, duke ju referuar të drejtës që Kodit Zgjedhor më ka dhënë si anëtar i Komisionit Rregullator, ftoj dhe kolegët e tjerë që të vlerësojnë këto ndryshime të propozuara nga ana ime pse jo dhe për të plotësuar, nëse edhe kolegët e tjerë, kanë propozime e sugjerime për të ndryshuar këto propozime dhe ju ftoj që t'i miratojmë në fund. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çaka! Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektaktit doja t'ju drejtohesha zotit Sekretar të Përgjithshëm dhe drejtoreshës së

*Zbardhi materialin audio
Merița DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

Drejtorisë së Ligjshmërisë. Duke qenë se akti bazë pra, Kodi Etikës është miratuar nga ana jonë me propozimin tuaj, të Komisionerit, pasi keni parë ndryshimet e propozuara, duke qenë se ndërlidhen dhe me akte të tjera si psh rregullorja e institucionit, vlerësoni që ka momentalisht ndonjë përplasje që mund ta rregullojmë gjatë diskutimeve të sotme? Në dijeninë time rregullorja është ende duke u punuar, rregullorja e insitucionit. Po zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Do të flasë drejtoresha!

Znj. I. Nano: Po!

Znj. M. Koja: Jemi njohur me ndryshimet e Kodit të Etikës. Shprehim dakordësinë tonë. Nuk kemi për të propozuar shtesa apo ndryshime të tjera. Ndërkohë përsa i përket përputhshmërisë me rregulloren, jemi duke e finalizuar atë. Kështu nëse do të jetë e udhës për të bërë ndonjë ndryshim do ta reflektojmë atë në rregullore. Ju faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Fillojmë kolegë me shqyrtimin e projektaktit. Kolegë, në parim kemi diçka në lidhje me projektaktin e propozuar nga zoti Çaka? Jo! kalojmë në votimin në parim të projektaktit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen. Në këtë moment dhe kolegu nga Organizata KRIIK, nëse ka diçka? Nuk keni gjë për përmbajtjen e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

projektaktit. Atëherë, nuk po ju pyes nen për nen, faleminderit! Te projektvendimi, me propozimin e një anëtari të Komisionit Rregullator, do t'ju lutesha, për ta reflektuar gjatë zbardhjes, sepse në projektvendimin e printuar ka ardhur “me propozim të Komisionerit”. Pra, me propozimin e një anëtari, Komisioni Rregullator vendosi:

1. Në tekstin e Kodit të Etikës, miratuar me vendimin nr. 22, datë 23.02.2022, të Komisionit Rregullator, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në nenin 7, pika 1, pas shkronjës “c”, të shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
d) Rregullat e hollësishme për veshjen dhe paraqitjen në punë, përcaktohen nga Rregullorja e brendshme e institucionit..

Ka diçka për nenin e parë? Është ajo që zonja Koja tha që nëse do të jetë nevoja do të reflektohen në një rregullore që ende nuk është miratuar, pasi t'i miratojmë ne.

Kalojmë në votimin e pikës 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Neni 2. Në nenin 9 paragrafi i dytë përpara fjalës “punonjësit” shtohet fjala “zyrtarët”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, fjala “Nëpunësi” zëvendësohet me “Zyrtari/punonjësi”.

b) Pas pikës 5, shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

“Zyrtari/punonjësi, i cili gjatë ushtrimit të detyrave të tij, ka fituar ose ka njohuri mbi të dhëna personale të individëve/subjekteve, i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit mbi to, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9887, dt.10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.”.

Kush është dakord me nenin 3?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Neni 4. Në nenin 15/2 pas fjalës “ish zyrtari”, shtohet “ish punonjësi”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pas nenit 15, shtohen nenet 15/1 dhe 15/2 me këtë përmbajtje:


“Neni 15/1. Komunikimi me median.

- Në lidhje me marrëdhënien me median dhe deklaratimet publike, zyrtari/punonjësi nuk duhet të bëjë deklaratime në publik ose media, që mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit, si dhe që mund të interpretohen apo lidhen me pozicionin e tij në KQZ

Neni 15/2. Kontaktet me organe të tjera të administratës publike/shtetërore.

- Zyrtari/punonjësi, duhet të respektojë rregullat e etikës të përcaktuara në këtë Kod, në çdo rast kur kontakton me organe të tjera të administratës publike/shtetërore dhe punonjës të saj. Në këto kontakte ai duhet, paraprakisht, të bëjë prezantimin zyrtar nëpërmjet kartës identifikuese të institucionit, të shpjegojë qëllimin e kontaktit, si dhe të shmangë çdo shfaqje të arrogancës apo presionit ndaj një organi tjetër të administratës publike/shtetërore.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

Votojmë pikën 5 të projektvendimit!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 6. Në nenin 16, pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

3. Zyrtari/punonjësi duhet të kërkojë këshillim nga njësia e personelit te institucionit kur është i pasigurt për të vepruar.

4. Eprori direkt i zyrtarit/punonjësit ka përgjegjësi të kontrollojë nëse ai zbaton rregullat e parashikuara në këtë kod dhe të propozojë masat e duhura disiplinore për shkeljet e tij.

5. Shkeljet e rregullave të përcaktuara në këtë kod, kur nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen në rrugë administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 7. Kudo në tekst pas fjalëve “zyrtari/zyrtarët”, shtohet “punonjësi/punonjësit”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Para se të shkojmë në hyrjen në fuqi dhe publikimin, nga kolegët kemi ndonjë gjë tjetër? Nga administrata nuk kishim ndonjë propozim për shtesë, apo ndryshim.

Zonja Vukaj!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

Znj. H. Vukaj: Në kuadër të inisiativës së kolegut, të cilën e përshëndes! Mund të them që kolegu ishte i qartë në atë çfarë relatoi, por nuk ndërpreva më herët, çfarë kolegu propozoi dhe ne votuam, për hir të trupëzimit që ato kishin. Për një qartësi më mirë dhe një konvergim më të mirë të të gjithë qasjes që ka kolegu në lidhje me këtë kod dhe zbatimit të tij pa keqinterpretime, apo pa konfondime, nga grupet e përfshira, unë propozoj që neni 2, të ketë qartësi dhe të marrë këto ndryshime...

Znj. I. Nano: Neni 2 i kodit aktual, apo jo?


Znj. H. Vukaj: Po neni 2 i kodit aktual...

Znj. I. Nano: Dakord!

Znj. H. Vukaj: Neni 2 ka të bëjë me fushën e veprimit. Në mënyrën se si është draftuar dhe është miratuar nga ne, ka morinë e organeve dhe zyrtarëve të përfshirë në një trupë të vetme. Në kuadër të zbatimit më mirë të propozimeve të kolegut, unë propozoj që pika 1 të marrë një qasje tjetër. Pra, të ketë ndarjen në dy grupe, të personave, apo individëve që i cek kjo fushë veprimi, apo subjekte të së cilës janë në këtë kod. Atëherë, do të doja që të përfshinim kategorinë e të gjithë të zgjedhurve, organet drejtuese në këtë rast nga parlamenti, të cilët nuk hyjnë në kuptimin e këtij kodi në kategorinë “zyrtarë/punonjës”, por janë kategori e veçantë. Kategoria e dytë të jetë kategoria “zyrtarë/punonjës” dhe më pas, aty të reflektohet qartësisht se kush konkretisht bën pjesë në kategorinë “zyrtarë/punonjës”. Pra pika 1, të ketë diferencimin, ndarjen mes dy kategorive. Siç e dimë, kategoria e parë është:

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- Komisioni Rregullator

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

- Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve;
- Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Kategoria e dytë, ashtu siç fusha e veprimit, neni 2 i kodit të miratuar aktualisht, janë:

- Nëpunësit civilë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Punonjësit e punësuar me kohëzgjatje të pa caktuar sipas Kodit të Punës;
- Punonjës të punësuar në Kabinetin e KSHZ;
- Punonjësit e punësuar me kohëzgjatje të caktuar gjatë periudhave zgjedhore;
- Administrata zgjedhore e niveleve të tjera në periudha zgjedhore, dhe
- Praktikantët të cilët ushtrojnë praktikën pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Besoj, administrata e ka të qartë, apo ka nevojë për qartësim më shumë?

Znj. I. Nano: Votojmë propozimin për të bërë ndarjen e dy kategorive. Brenda pikës 1 të bëhet një rindarje dhe pastaj në zbardhje...

Z. M. Çakaj: Pra, në vendimin nr. 22, të transfozohet parashikimi i Kodit Zgjedhor, lidhur edhe me zyrtarët, edhe me të zgjedhurit.

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin e propozimit të zonjës Vukaj!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)


Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika e fundit, ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord kolegë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.24.01.2024*

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit ku kemi të gjitha propozimet e materializuara në një projektvendim nga zoti Çaka dhe propozimin e sapo votuar të zonjës Vukaj.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Çështje tjetër në rendin e ditës nuk kemi, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 01

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

